



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KURRKULA ME ZGJEDHJE

Lënda: Letërsi

Shkalla: VI

Klasa: XII

Tiranë, 2017



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
I. HYRJE.....	3
II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË ME ZGJEDHJE	5
1. Qëllimet e arsimit parauniversitar	6
2. Qëllimet e programit të letërsisë me zgjedhje.....	7
3. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës	7
4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së gjashtë	9
5. Lidhja e letërsisë me zgjedhje me temat ndërkurrikulare.....	12
6. Lidhja e letërsisë me zgjedhje me fushat e tjera të të nxënit	12
7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre	13
8. Ndarja e kohës mësimore	15
III. PËRMBAJTJA E LËNDËS SË LETËRSISË ME ZGJEDHJE	17
IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE	29
V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	32
VI. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISËT E TË NXËNIT	34

I. HYRJE

Lënda e letërsisë me zgjedhje bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Letërsi me zgjedhje (klasa XII), Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen dhe zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Letërsia me zgjedhje zgjeron dhe thellon njohuritë e marra në lëndën e letërsisë bërthamë. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve. Kjo lëndë, gjithashtu, u krijon mundësi nxënësve që të njohin dhe të vlerësojnë pasurinë tonë folklorike, si dhe të analizojnë dhe të gjykojnë ndikimet që letërsia shqipe ka pasur nga folklori.

Letërsia me zgjedhje zhvillohet në klasën e dymbëdhjetë. Programi i saj mbështetet në njohuritë, shkathësitë, vlerat dhe qëndrimet që nxënësit kanë fituar deri në klasën e njëmbëdhjetë. Lënda ka dy boshte kryesore, të cilat janë folklori shqiptar dhe ndikimi i letërsisë nga ky folklor, duke marrë kështu trajtën e një letërsie të krahasuar.

Letërsia gojore është një burim i pashtershëm për njohjen e kulturës, të filozofisë, të jetës dhe të shpirtit artistik të popullit tonë. Si e tillë, ajo duhet njohur dhe duhet studiuar, në mënyrë që nxënësit ta duan dhe ta vlerësojnë atë, si një pasuri të vlerë dhe të krahasueshme me folklorin e popujve të tjerë.

Folklori, gjithashtu, ka qenë dhe është burim frymëzimi për shkrimtarët tanë, pasi ata gjejnë në të shtratin e përshtatshëm dhe unik për të ndërtuar veprën e tyre. Gjatë zhvillimit të lëndës, nxënësit do të studiojnë krijime folklorike të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Po kështu, nxënësit do të analizojnë dhe do të vlerësojnë elementet e përmbajtjes dhe të formës letrare, për të cilat shkrimtarët janë ndikuar nga folklori, natyrisht edhe duke i tjetërsuar dhe duke u dhënë trajta origjinale. Nxënësit do të gjykojnë për vlerat dhe për origjinalitetin që ndikimi nga krijimtaria gojore popullore i jep veprës së një shkrimtari.

Letërsia me zgjedhje, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyç, të cilat janë të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, në mënyrë që ai të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj.

Njësoj si lënda e letërsisë bërthamë, edhe lënda e letërsisë me zgjedhje ndërton dhe zhvillon të njëjtat kompetenca lëndore, që janë:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i folklorit dhe vlerësimi i letërsisë shqipe në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Mirëpo kompetenca zhvillohet vazhdimisht, gjatë gjithë jetës, dhe nuk ka pikëmbërritje. Në lëndën e letërsisë me zgjedhje, nxënësit kanë para tyre sfida të reja. P.sh., ata zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrime në lidhje letërsinë gojore dhe të shkruar, edhe në rrafsh krahasues.

Programi i letërsisë me zgjedhje bazohet në parimin e integritit dhe në parimin e rimarrjes së njohurive, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË ME ZGJEDHJE

Hartimi i programit të letërsisë me zgjedhje mbështetet në Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar, në kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të gjimnazit. Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e letërsisë me zgjedhje për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve shkollore do ta përdorin programin e letërsisë me zgjedhje për të hartuar tekste që janë në funksion të analizës së plotë dhe funksionale të krijimeve folklorike dhe të autorëve të ndryshëm.

Prindërit dhe komuniteti, nëpërmjet programit lëndor, mund të informohen për njohuritë, aftësitë dhe vlerat që marrin fëmijët e tyre në lëndën e letërsisë me zgjedhje.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin e letërsisë me zgjedhje për qëllime inspektimi, vlerësimi, monitorimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i letërsisë me zgjedhje ka në fokus realizimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyç dhe të kompetencave të lëndës do të realizohen edhe temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, me shoqërinë dhe me tregun e punës.

Në program përshkruhet, gjithashtu, lidhja e letërsisë me lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë/çështjet mësimore, aftësitë/shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhet të fitojë nxënësi gjatë zhvillimit të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Në program është sugjeruar edhe shpërndarja e orëve mësimore.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit të letërsisë me zgjedhje.



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;

- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e programit të letërsisë me zgjedhje

Nëpërmjet studimit të letërsisë me zgjedhje, nxënësit:

- do të analizojnë dhe do të vlerësojnë në mënyrë kritike tekste të ndryshme letrare (të letërsisë dhe të folklorit);
- do të analizojnë dhe do të krahasojnë tekste folklorike dhe tekste të shkrimtarëve që janë ndikuar nga folklori;
- do të vlerësojnë krijimet folklorike, si një dëshmi për të kuptuar thelbin dhe psikikën tonë;
- do të gjykojnë për vlerat që mbështetja në folklor i jep një vepre letrare;
- do të komunikojnë idetë e tyre me një gjuhë shprehëse dhe bindëse;
- do të ndajnë me të tjerët idetë e tyre, duke qenë të vetëdijshëm për larminë e pikëvështrimeve dhe të interpretimeve rreth teksteve letrare;
- do të gjykojnë për vlerat estetike të gjuhës në një tekst letrar;
- do të ndërjegjësohen për marrëdhëniet mes teksteve dhe kontekstit të tyre kulturor;
- do të vlerësojnë rëndësinë shoqërore, historike dhe kulturore të folklorit dhe të letërsisë;
- do të lexojnë tekste në mënyrë të pavarur;
- do të dashurojnë letërsinë dhe leximin.

3. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës


Realizimi i kompetencave kyç të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për ta përmbushur në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të nxënies. Kur nxënësi përmbush kompetencat e lëndës së letërsisë me zgjedhje, ai njëkohësisht zhvillon edhe kompetencat kyç. P.sh., gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe zhvillon, kështu, edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënies të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënies të kompetencave kyç në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës mësuesi

ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënit të kompetencave kyç për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/përmbajtjet mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit mësimor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor në lëndën e letërsisë me zgjedhje.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës.



4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së gjashtë

Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar kompetencat kyç që duhet të zotërojnë nxënësit, me qëllim që ata të përshtaten dhe të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi. Këto kompetenca kyç janë zbërthyer në rezultate të nxëni në kurrikulën bërthamë. Rezultatet e të nxënit realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit dhe lëndëve mësimore. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, ku bën pjesë edhe lënda e letërsisë me zgjedhje, ndihmon në realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë me zgjedhje.

Shkalla VI Klasa XII
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- shpreh para një audience të caktuar mësimore çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes të paktën një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike) etj.;- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafesh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin dhe leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që bart secili paragraf;- prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe komunikon në mënyrë efektive me audiencë duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike;- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë e me shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.;- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;- përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit dhe kryerjes së detyrave në një fushë mësimore të caktuar.
Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve;
- analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë;
- hulumton, në mënyrë të pavarur, për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.

Kompetenca e të nxënit**Nxënësi:**

1. demonstroi shkathhtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh.: për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.);
2. diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë mësimore të re (ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarët); tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathhtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;
3. shfrytëzon, në mënyrën e duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;
4. përpunon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, informacionet për një temë të caktuar; rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.
5. paraqet një plan studimi para të tjerëve (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.), duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit;
6. përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka përdorur për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;
7. vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.;
8. menaxhon, në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/punës etj.), gjatë kryerjes së një veprimtarie ose detyre të caktuar në një

fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

1. paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillim të karrierës në një fushë të caktuar;
2. merr nisma të suksesshme për organizimin e veprimtarive të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.

Kompetenca personale

Nxënësi:

- tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, garave sportive, apo veprimtarive kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë veprimtarive dhe gjatë jetës së përditshme;
- prezanton, në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;
- shpreh në forma të ndryshme qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

1. prezanton, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;
2. paraqet, në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
3. merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

1. përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmohatarët gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë edhe të nxënës në distancë;
2. vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
3. është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimit dhe të të nxënës për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.

5. Lidhja e letërsisë me zgjedhje me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë një mënyrë për të integruar kompetencat kyç në fushat e të nxënës ose lëndët mësimore. Ato janë çështje të rëndësishme, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i temave ndërkurrikulare i ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Letërsia, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore që mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga letërsia shqipe dhe nga folklori zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar dhe njohjen e vlerësimit të kulturës sonë. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup në orë të ndryshme mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata të nxënës, gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e letërsisë me zgjedhje, ndihmojnë në aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

6. Lidhja e letërsisë me zgjedhje me fushat e tjera të të nxënës

Lënda e letërsisë me zgjedhje lidhet me shumë lëndë të arsimit të mesëm të lartë. Natyrisht, letërsia me zgjedhje ka lidhje, më së shumti, me lëndët që përbëjnë fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, pra me letërsinë bërthamë, me gjuhën shqipe dhe me gjuhën e huaj.

Lidhja e drejtpërdrejtë është me letërsinë bërthamë. Lënda e letërsisë me zgjedhje “përdor” dhe zgjeron njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që nxënësi ka fituar në letërsinë bërthamë. P.sh., nxënësi ka lexuar, analizuar, interpretuar dhe vlerësuar poemën “Lahuta e Malcis” nga letërsia bërthamë, ndërsa në letërsinë me zgjedhje nxënësi identifikon ndikimet e Fishtës nga folklori, mënyrën se si i trajton elementet folklorike dhe mitologjike, si dhe vlerat që i japin veprës së Fishtës këto elemente folklorike. Lidhja me letërsinë bërthamë qëndron edhe në faktin që letërsia me zgjedhje ndërton dhe zhvillon të njëjtat kompetenca, si edhe letërsia bërthamë, por natyrisht me rezultate të nxëni të tjera.

Lënda e letërsisë ka lidhje me gjuhën shqipe. Folklori është dëshmi e shfaqjes së dukurive të ndryshme gjuhësore në periudha të ndryshme kohore, si dhe provë e pasurisë leksikore dhe e mundësive të pafundme shprehëse të gjuhës shqipe.

Studimi i letërsisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të vlerësojnë natyrën. Shpesh, natyra me bukuritë e saj shërben si burim frymëzimi për shkrimtarët dhe rapsodët. Leximi dhe studimi i këtyre krijimeve artistike tërheq vëmendjen e nxënësve drejt bukurive dhe vlerave të natyrës shqiptare (p.sh., leximi i disa këngëve nga Cikli i Kreshnikëve). Kjo do të thotë që letërsia mund të integrohet me shkencat e natyrës dhe me lëndët që përfshihen në këtë fushë.

Letërsia si lëndë mësimore mbështet studimin e shkencave shoqërore në mënyra të ndryshme. Leximi i veprave letrare, sidomos i këngëve historike dhe legjendare, ndikon në formimin dhe ndryshimin e botëkuptimeve dhe në kuptimin e ngjarjeve dhe të personaliteteve historike të vendit tonë. Gjithashtu, letërsia, dhe sidomos folklori, zbulon jetën shoqërore, marrëdhëniet njerëzore dhe filozofinë dhe mendësinë e popullit tonë në periudha të ndryshme historike.

Artet dhe studimi i tyre mbështeten nga studimi i letërsisë (si një nga artet). Analiza e veprave letrare mbështet kuptimin e “mjetit artistik”, si një term i përbashkët i të gjithave arteve, i cili përdoret nga artistët për të përcjellë mesazhet e tyre. Analiza e ilustrimeve (pamje, piktura etj.) në vepra të ndryshme letrare dhe shpjegimi i funksioneve të tyre mbështetin kuptimin e specifikave të arteve të bukura dhe mjeteve të tyre të shprehjes. Ilustrimi i analizave letrare me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit që të kuptojnë efektin emocional të muzikës, si dhe karakteristikat e veçanta të rrymave të ndryshme muzikore.

Kjo do të thotë që zbatuesit e këtij programi (më së shumti, mësuesit) duhet të realizojnë parimin e integritetit të letërsisë me njohuri, aftësi dhe shkathtësi të lëndëve/ fushave të tjera, të tilla si: *Letërsi, Gjuhë shqipe, Arte, Gjuhët e huaja, TIK, Shkenca shoqërore* etj.

7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Lënda e letërsisë synon të formojë dhe të zhvillojë te nxënësit dy kompetenca:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i folklorit dhe vlerësimi i letërsisë shqipe në periudha të ndryshme letrare dhe historike.¹

Puna për zhvillimin e këtyre kompetencave nuk duhet të bëhet e ndarë dhe e fragmentarizuar. Në procesin mësimor, gjatë çdo ore mësimore punohet për formimin e të dyja kompetencave. Kështu p.sh., nxënësi analizon dhe interpreton një tregim të Ernest Koliqit (i cili është ndikuar nga folklori), por edhe vlerëson risitë që solli Koliqi në letërsinë e gjysmës së parë të shekullit XX.

Përshkrimi i kompetencave

a) Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë, si lexues kritikë dhe të pavarur, vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare, të folklorit dhe të letërsisë shqipe. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësit nuk i mësojnë thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura. Gjithashtu, nxënësit aftësohen të krijojnë tekste të ndryshme artistike (poezi, përrallë, tregim etj.) duke u mbështetur në elementet e formës dhe të përmbajtjes së poezisë dhe të prozës popullore.

b) Vlerësimi i folklorit dhe vlerësimi i letërsisë shqipe në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Gjatë zhvillimit të lëndës së letërsisë me zgjedhje, nxënësit krijojnë një pasqyrë më të qartë:

- të vlerave artistike, estetike dhe kombëtare të folklorit shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë;
- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;

Gjithashtu, nxënësit krahasojnë tekste të letërsisë artistike me tekste folklorike në prozë dhe në poezi. Folklori studihet paralelisht me disa tekste të autorëve të letërsisë shqipe që janë

¹ Lënda e letërsisë me zgjedhje synon studimin e folklorit tonë dhe të letërsisë shqipe.

ndikuar nga folklori. Kështu, nxënësit do të shijojmë pasurinë e folklorit tonë, por edhe do të analizojnë dhe do të vlerësojnë modele veprash, të cilat kanë elemente të ngjashme me të. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kuptojnë që folklori nuk është një njësi e veçuar dhe e ndarë, por është pjesë e pasurisë letrare kombëtare.

8. Ndarja e kohës mësimore

Lënda e letërsisë me zgjedhje zhvillohet në dy orë mësimore në javë. Në klasën XII ka 34 javë mësimore. Orët mësimore të këtij programi ndahen në dy pjesë. Koha mësimore që sugjerohet të përdoret për njohuri të reja, për përsëritje, për testime etj., është **52 orë**. Ndërsa **16 orë** mund të përdoren për projekte, për ese, për studime ose hulumtime të ndryshme, si dhe për krijime artistike të nxënësve (tregime, poezi, përralla, piktura etj.), të cilat bazohen në motive ose elemente të tjera nga folklori.

Ndarjet kryesore	Orë të sugjeruara
Folkloristika	4 orë
Lirika popullore	14 orë
Epika popullore	16 orë
Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori ynë <i>Shënim.</i> Fragmentet nga veprat që studiohen në letërsinë bërthamë, punohen në një 1 orë mësimi.	18 orë
Projekte, dramatizime, ese, studime ose hulumtime të ndryshme, si dhe krijime artistike të nxënësve të cilat bazohen në motive ose në elemente të tjera nga folklori ynë.	16 orë
Gjithsej:	68 orë

Tema të sugjeruara për projekte dhe hulumtime të ndryshme

- Folklori dhe Fishta – *Duke rikujtuar gjithçka dini për epikën popullore, sidomos për Ciklin e Kreshnikëve, baladat dhe legjendat, bëni një krahasim mes tyre dhe poemës “Lahuta e*

Malcis”, për të vërtetuar atë që thotë kritika se Fishta, si i fundmi rapsod i Veriut, e ngriti epikën popullore.

- Identiteti shqiptar përmes krijimtarisë folklorike.
- Portreti femëror dhe vendi që zë femra në krijimtarinë folklorike.
- Folklori - një pasuri që duhet mbajtur gjallë (mbledhje e krijimeve folklorike nga krahina të ndryshme dhe mendime kritike e letrare rreth tyre).
- Kulti i diellit dhe i hënës në krijimtarinë popullore.
- Pasuria gjuhësore në krijimet e popullit.
- Lidhja e folklorit me artet e tjera popullore (muzika, koreografia etj.).
- E bukura dhe e veçanta e krijimeve folklorike nga krahina të ndryshme të Shqipërisë.

Mësuesi sugjeron dhe ndjek nxënësit gjatë gjithë procesit të hartimit ose shkrimit të eseve, studimeve, hulumtimeve, projekteve etj. Për vlerësimin e nxënësve në fund të periudhave 3-mujore, mësuesi mund të përdorë jo vetëm testin, por edhe detyra përmbledhëse (studime ose hulumtime).

III. PËRMBAJTJA E LËNDËS SË LETËRSISË ME ZGJEDHJE

SHKALLA VI

Klasa XII

Rezultatet e të nxënës

Nxënësi:

- analizon vlerat historike, kombëtare, estetike dhe etike të folklorit shqiptar;
- interpreton krijimet folklorike (përralla, legjenda, këngë etj.) duke u bazuar në njohuritë e fituara dhe në përvojën personale;
- dallon tiparet kryesore të epikës dhe të lirikës folklorike;
- analizon temën, motivet, subjektin dhe personazhet e krijimeve letrare folklorike;
- analizon tiparet e formës dhe të gjuhës në krijime folklorike dhe të letërsisë shqipe;
- analizon shfrytëzimin e traditës folklorike nga autorë të ndryshëm dhe veçon vlerat që merr krijimtaria e tyre;
- krahason tekste nga autorë të ndryshëm të letërsisë shqipe me krijime folklorike të ndryshme.

Çështjet ose njohuritë mësimore

Shkathësitë

Folklori dhe folkloristika

(sugjerohen 4 orë)

- Rëndësia e studimit të folklorit.
- Vështrim i përgjithshëm në folkloristikën shqiptare.
- Mbledhësit dhe studiuesit e folklorit shqiptar, si p.sh.: Frang Bardhi, Nikollë Filja, Gavril Dara, Jeronim de Rada, Thimi Mitko, Zef Jubani, Vinçenc Prendushi, Atë Donat Kurti, Atë Bernardin Palaj, Mitrush Kuteli, Han, Majer etj.
- Folklori dhe romantizmi. Romantikët (*shqiptarë dhe europianë*) si mbledhës dhe studiues të folklorit.

Nxënësi:

- sqaron kuptimin e termit “folklor”;
- vlerëson rëndësinë e studimit të folklorit, si një pasuri kombëtare shpirtërore dhe artistike;
- analizon objektin dhe funksionet e folkloristikës;
- veçon kontributet e hershme, veçanërisht të arbëreshëve, në mbledhjen e folklorit shqiptar (Frang Bardhi, Nikollë Filja, Gavril Dara, Jeronim de Rada etj.);
- vlerëson kontributin e Thimi Mitkos, Zef Jubanit, Vinçenc Prendushit, Atë Donat Kurtit, Atë Bernardin Palajt, Mitrush Kutelit etj., në mbledhjen dhe në studimin e folklorit shqiptar;
- vlerëson kontributin e studiuesve të huaj në lidhje me folklorin shqiptar;
- sjell argumente pse shkrimtarët romantikë e mblodhën folklorin dhe u ndikuan prej tij;

<ul style="list-style-type: none"> - Tiparet kryesore të folklorit (<i>karakteri anonim, improvizimi, motërzimet, karakteri kolektiv, përsëritja etj.</i>). - Ndarjet e folklorit (<i>krijime lirike, epike dhe dramatike</i>). - Folklori dhe letërsia moderne. 	<ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet kryesore të folklorit, si: karakteri anonim, improvizimi, motërzimet, karakteri kolektiv, përsëritja etj.; - i konkretizon disa tipare me krijime të ndryshme folklorike; - përcakton ndarjet kryesore të folklorit (epika, lirika dhe drama); - analizon interesin e shkrimtarëve të letërsisë moderne (<i>shqipe dhe botërore</i>) ndaj folklorit dhe miteve.
<p>Këngët e fëmijëve dhe ninullat ose këngët e djepit (<i>sugjerohen 3 orë</i>) Gjatë analizave letrare të këngëve për fëmijë dhe të ninullave, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e këngëve të fëmijëve. Humori, fantazia, shpirti krijues dhe psikologjia e fëmijës në këto këngë. - Mjetet që krijojnë ritëm dhe muzikalitet në këngët e fëmijëve, si: rima, aliteracioni, përsëritjet etj. Gjuha në këngët e fëmijëve. - Elementet fantastike, figurat mitologjike në këngët e fëmijëve. - Tiparet e ninullave, si krijime në të cilat janë pasqyruar komponentët më të rëndësishëm të traditës, të normave shoqërore dhe të etikës, si dhe rrethanat historiko-sociale që përfaqësojnë identitetin kombëtar të popullit tonë. - Vlerat që kanë ninullat në jetën dhe në zhvillimin e fëmijës. - Prania e figurave historike dhe mitologjike të ninullat. Kulti i trimërisë, i burrërisë dhe i mirësisë. - Ninullat e djemve dhe ninullat e vajzave. - Gjuha dhe figurat stilistike (<i>krahasimi, metafora, personifikimi</i>). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), strukturës dhe formës së këngëve të fëmijëve; - analizon humorin, fantazinë, shpirtin krijues dhe psikologjinë e fëmijëve në këngët e fëmijëve; - veçon mjetet, si rimat e brendshme, aliteracionet, përsëritjet e fjalëve, onomatopetë etj., si dhe analizon funksionet e tyre; - identifikon tiparet e gjuhës së këngëve të fëmijëve; - analizon funksionet e elementeve fantastike dhe të figurave mitologjike në këngët e fëmijëve; - dallon një krijim folklorik që është ninullë; - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), strukturës dhe formës së ninullave; - analizon tiparet e ninullave, si: individual, improvizimet, shprehja e dëshirës ose e kërkesës së nënave, gjuha e figurshme etj.; - analizon dhe gjykon vlerat që kanë ninullat në jetën dhe në zhvillimin e fëmijës; - interpreton dhe analizon praninë e figurave historike dhe mitologjike të ninullat, si dhe zbulon kultin e trimërisë, të burrërisë dhe të urtësisë në këto krijime; - krahason ninullat e vajzave me ninullat e djemve; - gjykon për mendësinë e popullit tonë (nënave) në lidhje me ëndrrat e dëshirat që ka për djemtë

	<p>dhe për vajzat, si dhe tregon se si ka ndryshuar me kalimin e kohës kjo mendësi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e gjuhës dhe shpjegon funksionin e figurave stilistike (<i>krahasimet dhe metaforat në portretizimin e fëmijës, personifikimi i gjumit etj.</i>); - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së ninullave ose të këngëve të fëmijëve.
<p>Këngët e dasmës (<i>sugjerohen 2 orë</i>) Gjatë analizave letrare të këngëve të dasmës, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e këngëve të dasmës. Kulti i gëzimit që shoqëron dasmën shqiptare. Ritet kryesore të dasmës. - Mjetet poetike për portretizimin e figurës së nuses dhe të dhëndrit (<i>krahasimet, metaforat etj.</i>) në këngët e dasmës. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (<i>kuptimit</i>), strukturës dhe formës së këngëve të dasmës; - përshkruan disa nga ritet kryesore që shoqërojnë një dasmë shqiptare; - krahason ritet e dasmave të së kaluarës me disa nga ritet e dasmave të ditëve tona; - vlerëson kultin e gëzimit, të optimizmit dhe të së bukurës që shoqëron gjithë momentet e dasmës; - analizon mjetet poetike (<i>krahasimet, metaforat etj.</i>) që përdoren për të portretizuar figurën e nuses dhe të dhëndrit në këngët e dasmës; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, strukturës dhe formës së këngëve të dasmës.
<p>Këngët e motmotit (<i>sugjerohen 2 orë</i>) Gjatë analizave letrare të këngëve të motmotit, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Festat pagane dhe ritet. Ngjashmëri me vendet e tjera. Elementet kryesore në ritet pagane dhe simbolika e tyre. - Këngët që këndohen në festa të ndryshme, si: Kolendrat, Dita e Verës, Shën Gjergji etj. - Motivet që trajtohen në këngët e motmotit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan disa nga ritet më të bukura që shoqërojnë festat pagane në vendin tonë; - krahasojnë ritet pagane në vendin tonë me vendet e tjera, sidomos me mitologjinë greke; - përshkruan ndonjë rit që është pjesë e jetës së familjes së tij ose të komunitetit; - interpreton simbolikën e elementeve kryesore (<i>uji dhe zjarri</i>) që shoqërojnë ritet pagane; - analizon motivet që trajtohen në këngët e motmotit; - vlerëson veçoritë gjuhësore në këngët e motmotit;

<ul style="list-style-type: none"> - Gjuha në këngët e motmotit (<i>onomatopetë, përsëritjet etj.</i>). 	<ul style="list-style-type: none"> - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së këngëve të motmotit.
<p>Gjëma dhe vajet (<i>sugjerohen 2 orë</i>) Gjatë analizave letrare të vajeve, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjëma e burrave në Shqipëri dhe në popujt e tjerë të Ballkanit. Ritet që shoqërojnë gjëmën e burrave. Vajtimit e grave. - Hyjnizimi dhe respekti për të vdekurin. Koncepti për vdekjen të gjëmat dhe vajet. Elementet pagane të gjëmat dhe vajet. - Ndikimi i vajtimit në psikologjinë e njeriut. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), të strukturës dhe të formës së vajeve; - evidenton të përbashkëtat dhe dallimet e gjëmave të burrave në disa vende ballkanike (p.sh.: Epi i Gilgameshit, vajtimi i Akilit për Patroklin etj.); - analizon ritet që shoqëronin gjëmën e burrave në veri të vendit; - përshkruan tiparet e vajtimeve të grave; - analizon dhe vlerëson hyjnizimin dhe respektin që i bëhet të vdekurit në vajtimit e grave; - veçon mjetet gjuhësore dhe stilistike me anë të të cilave portretizohet i vdekuri; - analizon konceptin që ka populli ynë për vdekjen (<i>proces i natyrshëm, ndërrim jete etj.</i>); - analizon ndikimet që ka vajtimi në psikologjinë e njeriut (<i>çlirim i dhimbjes, nderim dhe përkushtim ndaj të vdekurit etj.</i>); - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së gjëmave dhe të vajeve. - analizon elementet pagane të gjëmat dhe të vajet; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së vajeve.
<p>Këngët e dashurisë (<i>sugjerohen 5 orë</i>) Gjatë analizave letrare të vajeve, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrasti mes zakoneve që nuk e pranonin dashurinë dhe këngëve të dashurisë. - Larmia e këngëve të dashurisë. - Kulti i bukurisë (bukuria e femrës lidhet me shëndetin, me kultin e 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), të strukturës dhe të formës së këngëve të dashurisë; - analizon kontrastin mes zakoneve (kanunit të Lekë Dukagjinit dhe këngëve të shumta të dashurisë); - analizon modelin e bukurisë femërore në këngët e dashurisë;

<p>plleshmërisë dhe të amësisë). Krahasime me krijime folklorike të popujve të tjerë ose edhe me mitologjinë greke, p.sh., me Afroditën. Paraqitja e bukurisë fizike të femrës:</p> <ul style="list-style-type: none">) syri, qerpikët, vetullat;) goja dhe buzët;) qafa dhe gusha;) flokët;) kraharori, beli etj. <ul style="list-style-type: none"> - Kult i dashurisë (<i>dashuria - pasion, dashuria - sëmundje, dashuria - dhimbje, dashuria - mall</i>). Erotizmi në lirikat e dashurisë. - Personazhet kryesore të këngëve të dashurisë: <ul style="list-style-type: none">) Trimi, i dashuri, djali etj.) Vasha, e bukura, lulja etj. - Veçoritë metrike në këngët e dashurisë. Veçoritë stilistike: krahasimet, metaforat, simbolet (<i>lule, mollë</i>), hiperbolat etj. - Muzikaliteti (<i>përsëritje, anafora, epifora, asonanca, epanastrofe</i>). 	<ul style="list-style-type: none"> - krahason modelin e femrës në këngët tona të dashurisë me modelet femërore në mitologjinë greke ose edhe te popujt e tjerë; - vlerëson paraqitjen e bukurisë femërore (<i>syrin qerpikët, vetullat, gojën, buzët, qafën etj.</i>), si dhe evidenton vlerat estetike që shfaqen në këngët e dashurisë; - shpjegon se si përshkruhet dashuria (<i>pasion, mall, sëmundje, dhimbje</i>) në lirikat e dashurisë; - vlerëson elementet e erotizmit dhe të sensualitetit në këngët e dashurisë; - analizon tiparet e trimit ose të të dashurit, si p.sh.: besnik, këmbëngulës, trim, i ndjeshëm, sakrifikues, i mençur etj., dhe shpjegon se si përshkruhen këto tipare në këngët e dashurisë; - analizon tiparet e vajzës, si çapkëne, e shpenguar, e matur, e përgjegjshme, punëtore, gazmore, e çiltër, besnike, , e mençur etj., dhe se si përshkruhen këto tipare në këngët e dashurisë; - analizon dhe vlerëson pasurinë metrike të këngëve të dashurisë (<i>vargje, strofa e rima të ndryshme</i>); - analizon veçoritë stilistike të këngëve të dashurisë; - dallon figurat stilistike, si krahasimet, metaforat, simbolet, hiperbolat etj., dhe shpjegon funksionin e tyre; - dallon mjetet që krijojnë muzikalitet në këngët e dashurisë, si: përsëritje, anaforë, epiforë, asonancë, epanastrofe; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së këngëve të dashurisë.
<p>Ndikimet e shkrimtarëve nga folklori ynë</p> <p>Nxënësi analizon poezi dhe fragmente nga shkrimtarët e mëposhtëm, duke veçuar motivet, elementet e metrikës, të stilistikës dhe të gjuhës etj., që dëshmojnë ndikimet nga folklori:</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon në fragmente të ndryshme të krijimtarisë së De Radës (nga “<i>Këngët e Milosaos</i>”) ndikimet e tij nga folklori në përmbajtje të saj, në stil, në gjuhë, në trajtën e brendshme, në krahasime, në përshkrimin e atmosferës ku lëvizin personazhet etj.;

<ul style="list-style-type: none"> - Jeronim de Rada. - Gavril Dara i Riu. - Naim Frashëri. - Çajupi. - Lasgush Poradeci. - Dritëro Agolli. 	<ul style="list-style-type: none"> - kupton, analizon, interpreton dhe vlerëson fragmente të ndryshme nga <i>Kënga e Sprasme e Balës</i>, Gavril Dara i Riu, si dhe veçon ndikimet e tij nga folklori, si: motivet, heronjtë dhe tiparet e tyre, elemente nga mitologjia popullore, figurat stilistike, metrika etj.; - kupton, analizon, interpreton dhe vlerëson poezi të ndryshme dashurie të Çajupit, si dhe veçon ndikimet e tij nga folklori në trajtimin e motivit të dashurisë, në portretizimin e vashës etj.; - veçon në poezi të ndryshme të Naim Frashërit (<i>p.sh., nga cikli “Bukuria”</i>) ndikimet e tij nga folklori në konceptin e bukurisë dhe të dashurisë, në portretizimin e vashës, në figuracion, në metrikë etj.; - veçon në poezi të ndryshme të Lasgush Poradecit ndikimet e tij nga folklori në motive, në strukturë dhe në gjuhë; - veçon në poezi të ndryshme të Dritëro Agollit ndikimet e tij nga folklori; - krahason disa nga krijimet e këtyre shkrimtarëve me poezi popullore (përmbajtje dhe formë); - shpjegon vlerat dhe ngjyrimet që krijimtaria folklorike i jep krijimtarisë së këtyre shkrimtarëve.
<p>Proverbat dhe gjëgjëzat (<i>sugjerohen 2 orë</i>) Gjatë analizave letrare të proverbave dhe të gjëgjëzave, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Proverbat ose fjalët e urta. Çfarë janë dhe çfarë shprehin? - Lashtësia e proverbave. - Motivët e proverbave. - Veçoritë stilistike e metrike të proverbave, si: krahasimi, metafora, aliteracioni, antiteza, konciziteti (ngjeshja), dy vargjet (<i>rrallë tri vargje</i>), rima etj. <p>Gjëgjëzat</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), të strukturës dhe të formës së proverbave; - dallon proverbat, përcakton tiparet dhe vlerat e tyre; - diskuton rreth lashtësisë së proverbave dhe faktit që është shumë i vështirë përcaktimi i moshës së tyre; - analizon veçoritë stilistike dhe metrike të proverbave; - shpjegon funksionin e figurave stilistike (<i>krahasimi, metafora, aliteracioni etj.</i>) të proverbave;

<ul style="list-style-type: none"> - Lashtësia e gjëgjëzave. - Ndërtimi dhe forma e gjëgjëzave: pyetja, metafora, vargjet, rimat, humori. 	<ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (<i>kuptimit</i>), të strukturës dhe të formës së gjëgjëzave; - vlerëson rëndësinë dhe lashtësinë e gjëgjëzave; - analizon elementet e ndërtimit dhe të formës së gjëgjëzave të ndryshme, si: pyetja në fillim të gjëgjëzës, metaforat, llojin e vargut, rimën, humorin; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së proverbave dhe të gjëgjëzave.
<p>Legjendat dhe këngët legjendare (<i>sugjerohen 6 orë</i>)</p> <p>Gjatë analizave letrare të legjendave dhe këngëve legjendare, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Legjendat, llojet e tyre. - Leximi simbolik i legjendave. - Dallimet e legjendave nga përrallat. - Këngët legjendare. - Këngët legjendare të murimit: <ul style="list-style-type: none">) Riti i flijimit në qendër të këngëve legjendare të murosjes. Riti i flijimit nga antikiteti e deri në ditët tona.) Legjenda e murimit nëpër botë. Legjenda e murimit në Ballkan. Variantet e ndryshme të legjendës së murimit në Shqipëri.) Legjenda e Rozafës. Dokumentimi i legjendës së murimit të Barleti.) Miti i Rozafës, si një mënyrë për të kuptuar dhe për të zbuluar thelbin dhe psikikën tonë.) Interpretime të ndryshme të legjendës. Kompleksi i Rozafës. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (<i>kuptimit</i>), të strukturës dhe të formës së legjendave; - kupton domethënien e vërtetë të legjendave dhe të këngëve legjendare, duke lexuar poshtë ngjarjeve dhe duke kuptuar simbolikën e tyre; - përcakton tiparet e legjendave; - analizon llojet e legjendave dhe veçon tiparet e secilit lloj; - veçon të përbashkëtat dhe të veçantat e legjendave dhe të përrallave; - përcakton tiparet e këngëve legjendare; - përshkruan ritin e flijimit, i cili është në qendër të këngëve legjendare të murosjes, që nga antikiteti (<i>Agamemnoni flijon Efigjeninë</i>) deri në ditët tona (<i>flijimi i një kafshe në themelet e një ndërtese</i>); - analizon ekzistencën e legjendës së murimit në vende të ndryshme të botës; - krahason legjendën e murimit në Shqipëri me legjendat e murimit në vendet ballkanike; - krahason variantet e ndryshme të legjendës së murimit në Shqipëri; - analizon dhe vlerëson personazhet e kësaj kënge, si dhe përshkruan simbolikën që ata mbartin; - diskuton rreth interpretimeve të ndryshme të legjendës së Rozafës;

<ul style="list-style-type: none"> - Këngët legjendare të rinjohjes. - Motivi i rinjohjes në pasurinë folklorike botërore dhe në letërsi.) Rinjohja e burrit me gruan (<i>Ymer Aga, Lalë Bajrami, Veli Pasha etj.</i>). Kënga e Ymer Agës.) Rinjohja e vëllait me motrën. Variantet e ndryshme të kësaj kënge. Prania e një incesti të pakryer në shtratin e kësaj kënge legjendare.) Rinjohja e vëllait me vëllanë. Variantet e ndryshme të kësaj kënge. - Këngët legjendare të vëllait të vogël. Variantet në Europë dhe në folklorin tonë (<i>përfshirë edhe folklorin arbëresh</i>). Legjenda e Kostandinit dhe e Doruntinës. Besa dhe dashuria në legjendën e Kostandinit dhe të Doruntinës. Martesa jashtë fisit. 	<ul style="list-style-type: none"> - jep interpretimin e tij për legjendën, duke e argumentuar atë; - diskuton rreth interpretimit psikanalitik të të ashtuquajturit “<i>kompleks i Rozafës</i>”; - përshkruan fabulën e këngëve të rinjohjes; - analizon sfondin historik në të cilin janë krijuar variantet e ndryshme të këtyre këngëve; - diskuton rreth motivit të rinjohjes në folklorin e vendeve të ndryshme, si dhe në vepra të ndryshme të shkrimtarëve të ndryshëm (<i>Homeri, Dickens, Molier etj.</i>); - analizon variantet e ndryshme të këngëve të rinjohjes në folklorin tonë; - diskuton rreth varianteve të ndryshme të këngëve të rinjohjes së burrit me gruan në folklorin tonë, përfshirë edhe variantin arbëresh; - krahason figurën e Ymer Agës me Odiseon e Homerit; - veçon disa nga variantet kryesore të këngëve legjendare të rinjohjes së vëllait me motrën dhe diskuton rreth tyre; - përshkruan fabulën e këngëve të rinjohjes së motrës më vëllanë; - diskuton për praninë e një incesti të pakryer në shtratin e kësaj kënge; - përshkruan fabulën e këngëve të rinjohjes së vëllait me vëllanë; - diskuton dhe analizon variantet e ndryshme të rinjohjes së vëllait me vëllanë në folklorin tonë; - krahason variantet e vendeve të tjera me variantet e folklorit tonë për këngën e vëllait të vogël; - diskuton rreth interpretimeve të ndryshme të motiveve të legjendës së Kostandinit dhe të Doruntinës (<i>martesat jashtë fisit, mbajtja e besës etj.</i>); - diskuton rreth martesës jashtë fisit dhe se si trajtohet ky fakt në legjendën e Kostandinit dhe të Doruntinës;
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së këngëve legjendare.
<p>Ndikimet e shkrimtarëve nga folklori ynë</p> <p>Nxënësi analizon romanin “Kush e solli Doruntinën” të Ismail Kadaresë, duke veçuar elementet e formës dhe të përmbajtjes, të cilat dëshmojnë ndikimet nga folklori.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, analizon, interpreton dhe vlerëson romanin e Ismail Kadaresë “Kush e solli Doruntinën” (<i>mund të përdoren edhe fragmente nga vepra të tjera ose poezi</i>), si dhe veçon ndikimin nga legjendat popullore në elementet e formës dhe të përmbajtjes; - krahason romanin e Kadaresë me legjendën e Kostandinit dhe të Doruntinës (<i>përmbajtje dhe formë</i>); - shpjegon vlerat dhe ngjyrimet që krijimtaria folklorike i jep krijimtarisë së Ismail Kadaresë.
<p>Cikli i Kreshnikëve (sugjerohen 3 orë)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eposi ynë kombëtar. Rëndësia e tij. - Lashtësia e eposit tonë. Tematika, motivet dhe subjekti i eposit. - Personazhet reale dhe mitologjike. Veçoritë e ndërtimit të eposit. - Vështrim krahasues mes eposit tonë dhe eposeve të popujve të tjerë, si p.sh.: Këngët e Rolandit në Francë; Këngët e Sidit në Spanjë, Këngët e Nibelingëve në Gjermani. <p>Gjatë analizës letrare të këngës së Gjergj Elez Alisë, nxënësit marrin njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfshirja e kësaj kënge në Ciklin e Kreshnikëve. - Elementet që përcaktojnë vjetërsinë e këngës së Gjergj Elez Alisë. - Tematika, motivet dhe subjekti i kësaj këngë. Problemet shoqërore në këtë këngë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes, të strukturës dhe të formës së këngëve të Ciklit të Kreshnikëve; - analizon rëndësinë e eposit tonë kombëtar, si pasuri e çmuar e folklorit tonë; - përcakton epokën kur është krijuar eposi ynë, duke dhënë argumente; - veçon temat dhe motivet kryesore të eposit; - përshkruan shkurtimisht subjektin e eposit; - analizon personazhet kryesore të eposit dhe i krahason ata me personazhe të eposit grek ose të eposeve të popujve të tjerë; - analizon veçoritë e ndërtimit të eposit; - krahason eposin tonë me eposet e popujve të tjerë, si p.sh., Këngët e Rolandit në Francë; Këngët e Sidit në Spanjë, Këngët e Nibelingëve në Gjermani. - veçon disa elemente që vërtetojnë që kënga e Gjergj Elez Alisë është e vjetër, si: dyluftimi mesjetar, armët (topuzi), taksat etj.; - përshkruan subjektin e këngës së Gjergj Elez Alisë; - analizon temën dhe motivet e këngës, si: mbrojtja e atdheut dhe e nderit të familjes, motivi i dashurisë, motivi i trimërisë etj.;

<ul style="list-style-type: none"> - Personazhet kryesore: Gjergji, motra dhe bajlozi. Simbolika e personazheve kryesore. Koncepti i “tjetrit” në këtë këngë. - Veçoritë e ndërtimit të këngës. Kompozicioni i këngës. Stili dhe gjuha. 	<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan problemet shoqërore që pasqyrohen në këtë këngë; - analizon personazhet kryesore të këngës (motrën, Gjergjin dhe bajlozin), si dhe marrëdhënien mes tyre; - krahason Gjergjin me heronjtë e eposeve të tjera, në lidhje me frymën heroike, dyluftimin, lidhjen me armët, përballja me kundërshtarin e denjë etj.; - interpreton simbolikën e personazheve kryesore; - analizon kompozicionin dhe veçoritë e këngës; - veçon figurat stilistike dhe shpjegon funksionin e tyre; - analizon fundin e këngës duke elementet tragjike, si: përmendorja e dashurisë, zakonet mortore, gjëma, murana, varri i përbashkët, pema mbi varr etj.; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së këngëve të Ciklit të Kreshnikëve.
<p>Ndikimet e shkrimtarëve nga folklori ynë</p> <p>Nxënësi analizon fragmente nga poema epike “Lahuta e Malcis” ose nga vepra të tjera të Gjergj Fishtës, duke veçuar elementet e formës dhe të përmbajtjes letrare, të cilat dëshmojnë ndikimet nga folklori.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon në fragmente të ndryshme nga vepra e Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcis” (<i>mund të përdoren edhe fragmente nga vepra të tjera ose poezi nga “Mrizi i zanave”</i>), ndikimin nga Cikli i Kreshnikëve ose nga krijime të tjera folklorike; - krahason “Lahutën e Malcis” me Ciklin e Kreshnikëve (<i>në përmbajtje dhe në formë</i>); - shpjegon vlerat dhe ngjyrimet që krijimtaria folklorike i jep krijimtarisë së Gjergj Fishtës.
<p>Këngët historike (<i>sugjerohen 2 orë</i>)</p> <p>Gjatë analizës letrare të një kënge historike, nxënësit marrin njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat e këngëve historike. - Krahasimi i këngëve historike me këngët legjendare. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), të strukturës dhe të formës së këngëve historike; - veçon karakteristikat kryesore të këngëve historike; - krahason këngët historike me këngët legjendare;

<ul style="list-style-type: none"> - Këngët historike si burime informacioni për historinë. - Këngët historike të periudhave dhe figurave të ndryshme historike. 	<ul style="list-style-type: none"> - përcakton lidhjen mes historisë dhe këngëve historike, të cilat shërbejnë si burim informacioni për të (jo krejtësisht i besueshëm); - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së këngëve historike.
<p>Përrallat (<i>sugjerohen 3 orë</i>) Gjatë analizës letrare së përrallave, nxënësit marrin njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat e përrallës, si një nga format më të përhapura e më të njohura të prozës popullore. - Funksionet narrative të përrallës sipas Prop-it. - Krahasimi i përrallave me këngët legjendare. - Lashtësia e përrallave. Interesimi i studiuesve për përrallat. - Përrallat fantastike dhe përrallat realiste. Dallimi mes tyre. - Subjekti i përrallave. - Personazhet në përralla. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes (kuptimit), të strukturës dhe të formës së përrallave; - analizon karakteristikat e përrallës; - krahason përrallat me këngët legjendare (të përbashkëtat dhe dallimet); - përcakton kohën kur kanë lindur përrallat; - veçon disa nga kontributet e studiuesve në mbledhjen dhe në studimin e përrallave; - veçon karakteristikat e përrallës shqiptare, si p.sh., triumfi i të mirës mbi të keqen (<i>zbulon karakterin optimist të shqiptarit</i>); - analizon tiparet e përrallave fantastike dhe të përrallave realiste; - krahason përrallat realiste me përrallat fantastike; - analizon veçantinë e ndërtimit të subjektit të përrallave; - shprehet me shkrim dhe me gojë për elemente të ndryshme të kuptimit, të strukturës dhe të formës së përrallave.
<p>Ndikimet e shkrimtarëve nga folklori ynë Nxënësi analizon tregime, rrëfenja dhe poezi nga shkrimtarët e mëposhtëm, duke veçuar elementet e formës dhe të përmbajtjes letrare, të cilat dëshmojnë ndikimet nga folklori.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mitrush Kuteli - Ernest Koliqi - Lumo Skëndo - Martin Camaj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, analizon, vlerëson një rrëfenjë të Kutelit, si dhe veçon ndikimin e tij nga folklori (fabulën dhe skemën e përgjithshme, elementin fantastik, personazhet-fantazma, regjistrin, frazeologjizmat, rrëfimitarin që vetëm rrëfen etj.); - krahason një përrallë (<i>p.sh., Rinë Katerinëzën</i>) me një përrallë popullore; - kupton, analizon, vlerëson një tregim ose novelë të Koliqit (<i>p.sh., “Nusja e mrekuellueshme”, “Kërcimtarja e</i>

	<p><i>Dukagjinit</i>”), si dhe veçon ndikimin e tij nga folklori;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton, analizon, vlerëson tregimin “Plaku i Ylynecit” të Lumo Skëndos, si dhe veçon ndikimin e tij nga folklori; - kupton, analizon, interpreton dhe vlerëson një poezi ose një fragment të një vepre të Martin Camaj, si edhe veçon ndikimet e tij nga folklori; - shpjegon vlera dhe ngjyrimet që krijimtaria folklorike i jep krijimtarisë së këtyre shkrimtarëve.
--	--

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- vlerëson pasurinë folklorike të popullit tonë dhe të popujve të tjerë të Europës dhe më gjerë;
- bashkëpunon me të tjerët në projekte dhe detyra të përbashkëta që kanë lidhje me studimin e folklorit tonë;
- respekton idetë e të tjerëve në lidhje me çështje të ndryshme që kanë lidhje me folklorin;
- ndërmerr nisma në drejtim të ruajtjes dhe të studimit të folklorit tonë;
- respekton dhe vlerëson veprimtarinë e studiuesve të folklorit;
- e çmon folklorin dhe e konsideron atë si pjesë e pasurisë sonë shpirtërore dhe kulturore.

IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Vitet e fundit, në praktikën e shkollës sonë flitet për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Kështu, gjithnjë dhe më tepër, po zënë vend terma, të tillë si: mësimdhënia ndërvepruese, mësimdhënia me nxënësin në qendër, mësimdhënia e mbështetur në përdorimin e metodave për zhvillimin e mendimit kritik, puna me projekte etj.

Mësuesit të letërsisë, më shumë se çdo mësuesi tjetër, metodat dhe zhvillimet e mësipërme i japin mundësi që të zhvillojë një mësimdhënie cilësore, i krijojnë mundësi që nxënësit të lexojnë, të hulumtojnë, të krahasojnë dhe të nxjerrin përfundime për letërsinë në të gjitha elementet e saj.

Me mësimdhënie ndërvepruese kuptojmë përdorimin e veprimtarive që nxitin punën në grup. Bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetrin në procesin e të nxënësve të bëjë më efektiv dhe më të kënaqshëm mësimin. Pedagogjia bashkëkohore thekson faktin që nxënësit mund të mësojnë nga njëri-tjetri.

Puna me projekte është një nga format më të larta të veprimtarisë mësimore. Ajo i përfshin nxënësit në detyra me nivel të lartë kërkimor dhe hulumtues. Projektet kërkojnë nga mësuesit që t'u japin nxënësve kohën e duhur për të përgatitur projektet e tyre për çështje të caktuara me natyrë letrare. Ndërkohë, nxënësit socializohen, ndërveprojnë duke folur apo duke diskutuar me njëri-tjetrin, ata mësojnë të punojnë së bashku duke respektuar individualitetin e gjithsecilit dhe bëhen kompetentë të punës që ata paraqesin.

Metodat e mendimit kritik janë të pranishme, tashmë, në kontekstin e sotëm shkollor. Mësuesit e letërsisë duhet t'i bëjnë këto metoda pronë të punës së tyre mësimore. Përdorimi i tyre gjatë orës së mësimin u shërben nxënësve për të bërë gjykimin dhe vlerësimin e veprave dhe të autorëve duke i parë në këndvështrime dhe në qasje të ndryshme. Po kështu, ato bëjnë që nxënësit të jenë aktivë në analizën e veprave ose fragmenteve letrare dhe në mënyrë logjike t'i lidhin ato me rrethanat historike, sociale apo personale. Të parit me sy kritik bëhet, vetvetiu, pronë e nxënësve në këtë lëndë. Po kështu, metodologjia e përzgjedhur bën që studimi i veprave dhe i fragmenteve letrare sipas periudhave, të nxjerrë në pah tiparet e veçanta të tyre dhe të zhvillojë te nxënësit të përgjithësuarit dhe nxjerrjen e përfundimeve të qarta.

Parimet e mësimdhënies së lëndës së letërsisë

Parimet që udhëheqin mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në këtë lëndë janë: angazhimi personal, vlerësimi kritik dhe lidhjet kuptimplote.

Angazhimi personal

Mësuesit:

- do të krijojnë në klasë një mjedis pozitiv, në të cilin nxënësit të diskutojnë dhe të vlerësojnë tekste të ndryshme letrare;
- do të mundësojnë që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur me tekstet, të krijojnë përshtypjet dhe gjykimet e tyre, si dhe t'i ndajnë ato me të tjerët.

Vlerësimi kritik

Mësuesit:

- do të zhvillojnë te nxënësit aftësitë për vlerësuar në mënyrë kritike tekstet letrare;
- do të nxisin nxënësit që të mbrojnë gjykimet dhe vlerësimet e tyre me shembuj dhe ilustrime nga teksti.

Lidhjet kuptimplote

Mësuesit:

- do të udhëzojnë nxënësit që të bëjnë lidhje mes teksteve letrare, mes tekstit letrar dhe jetës së tyre, si dhe mes tekstit letrar dhe botës që i rrethon;
- do të nxisin te nxënësit dashurinë për letërsinë duke u dhënë mundësinë të njihen dhe të studiojnë vepra të gjinive dhe llojeve të ndryshme nga folklori dhe nga letërsia shqipe.

Kërkesa të veçanta të lëndës së letërsisë

Mësimdhënia e letërsisë duhet të synojë zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve, në mënyrë që ata të shijojnë dhe të vlerësojnë letërsinë në mënyrë kritike. Për të realizuar këtë, mësuesit duhet të përdorin si artin, ashtu edhe shkencën e mësimdhënies. Përmbajtja e lëndës do të ketë karakter të theksuar zbatues, duke mënjanuar e minimizuar karakterin parashtues dhe informues. Në thelb, procesi mësimor ka pasjen nga të gjithë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre në interesa, të njohurive dhe të shprehive paraprake. Ndaj, në qendër të zbatimit të programit është ballafaqimi i drejtpërdrejtë i nxënësit me letërsinë, aftësimi i tij për të evidentuar vlerat, për të mbajtur një qëndrim të tijin ndaj veprës, duke shmangur kështu parashtrimin e njëanshëm të saj nga mësuesi.

Në fillim të lëndës, mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me natyrën e zhvillimit të saj, me përmbajtjen, si dhe me çështjet që do të trajtohen. Në qendër do të jetë puna e pavarur dhe në grupe e nxënësve për të kuptuar konceptet e strategjitë bazë që mundësojnë analizën e pavarur të veprës letrare. Proces i të nxënësve do të mbështetet shumë në hulumtimin e informacionit dhe në lirinë e përzgjedhjes e të shprehjes së mendimeve të nxënësit për autorin dhe veprën letrare.

a) Rolet e mësuesit

Mësuesi është lehtësues dhe rregullator në procesin e mësimdhënies. Ai luan rol kyç për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për nxënie të pavarur. Për të realizuar misionin e tij, mësuesi:

- sqaron me nxënësit qëllimet e lëndës dhe përmbajtjen mësimore;
- krijon një atmosferë pozitive për procesin e të nxënësve;
- nxit dhe mbështet pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- përshtat mësimdhënien me interesat dhe reagimet e nxënësve;
- punon me nivele të ndryshme nxënësish dhe përshtat mësimdhënien në varësi të tyre;
- nxit cilësinë e bashkëveprimit në klasë;
- jep orientimet e duhura dhe vlerëson “kontributet” e nxënësve në procesin mësimor;
- përgatit dhe përzgjedh instrumente didaktike për aftësimin e nxënësit në analizën e pavarur të veprës letrare.

b) Rolet e nxënësve

Për nxënësit, më të rëndësishme janë shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhen zhvilluar, krahasuar me një grup njohurish që duhen marrë. Mësuesi duhet të sigurojë mbështetje dhe inkurajim, në mënyrë që nxënësit të lexojnë me dëshirë vepra letrare, si dhe të gjykojnë në mënyrë kritike për to. Ata duhet të ushtrojnë imagjinatën e tyre, të reagojnë me emocione dhe të krijojnë tekstet e tyre. Për të shpjeguar qartë opinionet dhe idetë e tyre, në një punë grupi, nxënësit duhet të zhvillojnë një fjalor kritik. Ndërkohë që bëjnë kritikën e teksteve, nxënësit kanë nevojë t’u besohet, të reflektojnë dhe të jenë të gatshëm të ndajnë me të tjerët punimet e tyre me shkrim. Nxënësit, gjatë vitit mësimor dhe në përfundim të tij, duhet të bëjnë përzgjedhjen e punimeve për të ndërtuar dosjen e punimeve të tyre.

V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi korrekt dhe sistematik i nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për synim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai duhet të shërbejë për disa qëllime, si:

- të sigurojë informacion rreth nivelit të arritjeve të nxënësve;
- të motivojë nxënësit;
- të shënojë përparimin e nxënësve;
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Gjatë procesit mësimor, mësuesit:

- duhet të identifikojnë nevojat dhe mangësitë e nxënësve në procesin e të nxënësve dhe të ndjekin strategjitë dhe metodat e duhura për të përmirësuar nivelin e të nxënësve;
- duhet t'u ofrojnë nxënësve mundësi, veprimtari dhe detyra të shumta e kuptimplote, në mënyrë që të zhvillojnë dhe të demonstrojnë aftësitë dhe progresin e tyre;
- duhet t'i udhëzojnë, t'i motivojnë dhe t'i nxisin nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre;
- duhet t'i qartësojnë nxënësit për qëllimin dhe kriteret e vlerësimit;
- duhet t'i përfshijnë nxënësit në procesin e vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndor. Gjatë zbatimit të programit, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi, dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një periudhe kohore. Ai mund të përmbajë detyra me shkrim, detyra tematike, projekte të ndryshme lëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi, në këtë rast, rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni ose të fëmijëve të shtetasve të huaj, banues në vendin tonë, merren parasysh nga mësuesit, duke u mundësuar këtyre nxënësve që të vlerësohen me mënyra të posaçme.

Mësuesi duhet t'u komunikojë prindërve, stafit pedagogjik të shkollës, organeve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara, herë pas here, rezultatet e përparimit të nxënësve. Ky komunikim

është mirë të jetë me shkrim dhe të përmbajë disa aspekte kryesore të punës së nxënësve, si: aftësitë, qëndrimi ndaj lëndës, pjesëmarrja në veprimtari, detyra me shkrim, sugjerime për përmirësimin e punës në të ardhmen etj.

Llojet e vlerësimit në letërsi

Vlerësimi dhe mësimdhënia janë të shkrira midis tyre brenda kurrikulës, në një mënyrë të pazgjydhshme. Por, për ta përdorur vlerësimin brenda mësimdhënies në mënyrë efektive, kërkohet, mbi të gjitha, të njihet fakti se instrumente të ndryshme të tij duhet të përdoren për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e mëposhtme janë vendimtare për arritjen e rezultateve të të nxënësve, të vendosura në lëndën e letërsisë.

Vlerësim diagnostikues kryhet, zakonisht, në fillim të nivelit, vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi për të nxënë (*i vazhdueshëm*) është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga ky lloj vlerësimi përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Fokusi i vlerësimit nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

Vlerësimi i të nxënësve (përmbledhës) kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet e të nxënësve përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në situata të njohura dhe të panjohura. Nëse nxënësit i zotërojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet në mënyrë të mjaftueshme, ata duhet t'i zbatojnë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies. Vlerësimi i të nxënësve nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara, por edhe një tregues i vlefshëm dhe i besueshëm i thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Të marra së bashku, të tria llojet e vlerësimeve formojnë një hartë të plotë për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve, e cila përfshin pikën e nisjes, rrugën që duhet ndjekur dhe pikëmbërritjen.

VI. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISET E TË NXËNIT

Në lëndën e letërsisë me zgjedhje, për arritjen e kompetencave, është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe i materialeve të shumta mësimore, për të krijuar mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet shkollore (*të shtypura dhe digjitale*), veprat letrare (*veprat letrare mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës*), revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, video-projektori, kompjuteri, interneti, CD-të etj.

Pjesa më e madhe e orëve të mësimit zhvillohet në klasë, ku mundësohen punët në grupe, dramatizimet, tryezat e rrumbullakëta. Gjithashtu, gjatë vitit mësimor nxënësit mund të shkojnë në biblioteka, të marrin pjesë në panairë të librit, të shkojnë në teatër ose në kinema, të zhvillojnë takime me shkrimtarë etj.